

# Çështje të trajtimit të kallëzuesit

Mr. Agim Spahiu

30 qershor 2000

## Përmbledhje

Në këtë shkrim autori është marrë me çështjen e trajtimit të kallëzuesit në gjuhësinë shqiptare, si një trajtim tradicional, kundruall trajtimit që i bëhet kësaj gjymtyre të rëndësishme sintaksore në teorinë e ndryshme gramatikore të gjuhësisë së përgjithshme. Ai nxjerr disa përfundime, nga ai grumbulli i të gjitha atyre teorive, duke dhënë sugjerime se si do të duhej të konceptohej kjo gjymtyrë në gramatikat e ardhshme të gjuhës shqipe.

Çështja se çka duhet të merret kallëzues e çka jo, ose cilat elemente e përbëjnë këtë gjymtyrë dhe cilat do të mbeten jashtë kësaj, edhe sot e kësaj dite ka mbetur si një prej çështjeve më problemore dhe më të vështira të fushës së sintaksës, jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në shumë gjuhë të tjera. Dhe, për mendimin tonë, të gjitha paqartësitë, luhatjet dhe inkosekuencat që po hetohen te kallëzuesi, por edhe te gjymtyrët e tjera, e kanë burimin te mosnjësimi i kriterit a kriterëve bazë. Kjo vetëkuptohet se studiuesit kanë të drejtë t'i qasen cilësdo çështje gjuhësore që atyre u shkon për shtati dhe që synojnë të arrijnë përfundime të caktuara. Kjo deri në njëfarë mase mund të arsyetohet. Por problemi bëhet akoma e më i madh kur studiuesi merr për bazë një kriter që sipas tij është i arsyeshëm, por e keqja më e madhe qëndron në faktin se edhe kur merret një kriter bazë, ai nuk i përmbahet ose nuk zbatohet si duhet e më përpikëri dhe kjo shkakton pastaj paqartësi dhe joobjektivitet. Prandaj gramatikanët francezë, duke u ballafaquar gjithnjë me këtë problematikë sa i përket kësaj çështjeje, ata në vitet e deceniet e fundit sikur e kanë kufizuar në masë të madhe përdorimin e termi *predicat* (le *predicat*). Ata në gramatikat e tyre të fundit më shumë parapëlqejnë të përdorin termin **Le verbe** dhe **Le goup verbal**<sup>1</sup>.

Edhe gramatikanët e gjuhës shqipe janë ndeshur sigurisht me këto vështirësi. Janë botuar disa artikuj për këtë gjymtyrë të rëndësishme, ku vihen në dukje kritere të ndryshme të trajtimit dhe të interpretimit të saj. Madje në këto vitet e fundit është botuar edhe ndonjë tekst shkollor në të cilin janë marrë për bazë disa kritere të tjera në trajtimin e

---

<sup>1</sup>Shih më gjerësisht për këtë: M. Riegel, Jean-Christophe Pellat-Rene Rioul, **Grammaire methodique du français**, Paris, 2003, f. 242-348/215-241; Bescherelle, **La Grammaire pour tous**, Hatier, 1997; Jean-Louis Fournir, **Grammaire française et impertinente**, Payot, 1992; O. Soutet, **La syntaxe du française**, bot. 3-të, Paris, 1989; etj.

kallëzuesit<sup>2</sup>. Por ndryshimet që i shohim në tekstin universitar **Sintaksa e fjalisë**, ribotuar disa herë në këto vitet e fundit në Tiranë e Prishtinë, lidhur me këtë problematikë janë shumë të pakta, për të mos thënë se ato nuk ekzistojnë fare që nga vitet e 80-ta. Dhe kjo është më brengosëse për vetë faktin se kjo njësi dhe teksti në përgjithësi është produkt i studiuesve më eminentë dhe më kompetentë, siç është Instituti i Gjuhësisë i ASHSH-së. Dhe ajo që është edhe më brengosëse është fakti se ky tekst universitar, sipas mendimit tonë është mbështetur kryesisht në kriteret që i kanë zbatuar studiuesit e Akademisë së ish-Bashkimit Sovjetik në vitet 50-60 e më vonë të shekullit të kaluar. Themi kështu se në trajtimin e kallëzuesit (por edhe të gjymtyrëve të tjera) me një krahasim shumë të thjeshtë dhe të shpejtë mund të vërehen paralelizma si fjala vjen, në klasifikimin e tij: duke u mbështetur në bazë të numrit të gjymtyrëve përbërëse: Si te ne, po ashtu edhe te ata sovjetikë kallëzuesi është ndarë fillimisht në

- a) Kallëzues foljor/të thjeshtë e të përbërë, dhe
- b) Kallëzues emëror.

Për sajimin e këtij të fundit merret gjithmonë për bazë struktura: këpujë (folja **jam**) dhe një gjymtyrë nominale çfarëdo. Po ashtu, si te ne po ashtu edhe në ato të akademisë sovjetike e ndeshim kallëzuesin e sajuar me anë të tri gjymtyrëve, etj. etj.

Një klasifikim të këtillë ose të ngjashëm e ndeshim të shtjelluar edhe në gramatikat bullgare, serbe, madje edhe në ato rumune<sup>3</sup>.

Klasifikimi i kësaj gjymtyrë të fjalisë në **Gramatikën e gjuhës shqipe II (Sintaksa)** nuk është për t'u hedhur poshtë, pavarësisht se është hartuar në mbështetje të kriterëve gramatikore të gjuhës ruse (ndonëse me me këtë gjuhë shqipja nuk ka asgjë të përbashkët). Por këtu të rëndësishme janë kriteret bazë, mbi të cilat u shpjegua dhe u interpretua kjo kryegjymtyrë dhe gjymtyrët e dyta, si dhe mbarë sintaksa e periudhës, në përgjithësi. Këtu i ndeshim shumë të dhëna të sqaruara mirë e të përkufizuara drejt, sidomos ndërtimet e përbëra nga foljet gjysmëndihmëse modale: *mund, duhet, do* etj. , ato aspekte, si: *filloj, nis, zë, bëj, vijoj, vazhdoj, pushoj, mbaroj* etj. , togjet e tipit: *vij+ përcjellore*, të cilat shprehim rritje përpjestimore progresive (P. sh. Niveli i lumit **erdhi duke u rritur**); ato me strukturë *këpujë+ përcjellore* (**jam duke punuar/Isha duke punuar**), togjet foljore të bashkërenditura të tipit: *shkoi e i thatë* gjuhës popullore, etj. Pra, të gjitha këto trajta të bashkuara foljore janë trajtuar drejt në gramatikën e lartpërmendur. Por këtu mund t'i vëmë re edhe disa paqartësi e pasaktësi, në përkufizimin e kësaj gjymtyrë, si fjala vjen: Në këtë gramatikë nuk është arritur të shpjegohet njëherë e mirë, me kriteret të sakta, përdorimi i trajtave të pashtjelluara të foljeve me vlerë kallëzuese. Në këtë pikë ka shumë herë luhatje dhe inkonsekuenca. Po ashtu secili studiues mund të shtrojë edhe këso pyetjesh: A duhet të merret si kusht që trajta e pashtjelluar foljore të lidhet me një kryefjalë të vetme për t'u pranuar si kallëzues? A

<sup>2</sup>Shih për këtë tekstin e B. Becit, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, botuar në Tiranë më 2001 në të cilin e shohim një konceptim tjetër të kriterëve dhe të terminologjisë sa i përket kallëzuesit.

Ky autor kallëzuesin e quan **grup foljor** në f. 174 e gjetiu, ndërsa ndërtimin: këpujë+ gjymtyrë nominale si **kallëzuesor i kryefjalës**, f. 197 e gjetiu

<sup>3</sup>Shih fillimisht vëllimin ASHR-së: **Gramatika limbi romane II**, Bukuresht, 1966, e më vonë.

duhet të pranohet si kallëzues foljor trajta e pashtjelluar kur është e zgjeruar, me ndonjë kundrinor a rrethanor, edhe pse nuk e ka lidhjen direkte me kryefjalë të vetme? A duhet të trajtohen funksionalisht si të ngjashme rastet e tipit, si: *Iku duke bërtitur* dhe *Iku duke nxituar* me vrap drejt qytetit (!). Pse nuk trajtohen, si ndërtime analogjike edhe rastet me trajta të pashtjelluara si: *Është duke punuar* (merret si kallëzues foljor) dhe *Është për t'u lavdëruar* (merret si kallëzues emëror) e të ngjashme.

Në këtë **Gramatikë të gjuhës shqipe (II)** ndeshim edhe disa mospajtime në shtjellimin dhe trajtimin e kësaj gjymtyre. Këtu shohim edhe disa gjëra të tjera që bien ndesh me ato që thuhet në gramatikat e gjuhëve të tjera. Kështu, fjala vjen, përderisa në disa gramatika të gjuhës gjermane, ndërtimet: *Është i lumtur* dhe *Është në shtëpinë* të shumtën e rasteve i trajtojnë si ndërtime analogjike me vlerë predikative (krhs: **Er ist Student** dhe **Der Lehrer ist dort**<sup>4</sup>, në gjuhën tonë, shembulli i parë merret si kallëzues emëror, ndërsa i dyti, jo, me arsyetim se folja **jam** në këtë rast e ka kuptimin: *ndodhem, gjendem* etj.

Në kohë të fundit, gramatikanët e huaj, pas shumë orvatjesh, po i kthehen meto-dave çomkiste të zbërthimit të njësive gjuhësore. Sipas N. Çomski-t, **sentenca** (fjalja) përgjithësisht mund të zbërthehet në një frazë nominale dhe në një frazë verbale. Frazja nominale, thuhet më tej aty, zbërthehet në: **nyjë dhe në emër**, ndërsa **frazja verbale në folje dhe në frazë nominale**, e paraqitur me këto simbole:

1. Sentece ————— NP + NV (*The man hit the ball*);
2. NP ————— T + N (*The man*);
3. VP ————— Verb + NP (*Hit the ball*)<sup>5</sup>.

Kështu, duke i shfletuar disa gramatika të gjuhës frënge, të botuara në vitet e fundit, shohim se kallëzues (Le predicat) konsiderohet jo vetëm folja, por edhe gjymtyrët e tjera të varura prej saj, si kundrinori i drejtë dhe i zhdrejtë, disa lloje rrethanorësh, përcaktori kallëzuesor, madje edhe disa fjali të nënrenditura ftilluese e rrethanore, kuptohet të varura nga folja-kallëzues e fjalisë drejtues. Sa për ilustrim po i sjellim këtu edhe disa të dhëna nga gramatika e autorëve Grevisse e Goosse me titull: **Nouvelle grammaire française**, 1995. Në këtë gramatikë e gjejmë në fillim këtë përkufizim të thjeshtë: *Predikati është gjithë ajo që thuhet për subjektin* (f. 82). Pastaj, po aty, thuhet se ai mund t'i ketë dy forma a) Kur predikati është një folje, dhe b) kur predikati përbëhet nga një element verbal, që ne (thotë autori, A. S. ) e quajmë copule (shqip =këpujë, A. S. ), dhe një element nominal a adjektival, që quhet atribut<sup>6</sup>. Po aty në shënimin numër 2 bëhet fjalë edhe për rastet kur predikati është i formuar nga një grup i zgjeruar (important). Në lidhje me këtë ata kanë sjellë shembujt, si: *Socrate a bu la ciguë*; dhe *Le policier sait qui a fait le coup*. Predikatet: *a bu la ciguë* dhe *sait qui a fait le coup*, përbëhen nga bërthamat e tyre foljore (a bu; sait) me të cilën shënot numri dhe veta e subjektit, dhe nga elementet

<sup>4</sup>Shih: Helbig/Buscha, **Leitfaden der deutschen Grammatik**, 1998, f. 208.

<sup>5</sup>Shih N. Comski, **Sintaksicke strukture**, Beograd, 1984, f. 35-37.

<sup>6</sup>po aty, f. 82 § 100.

e tjera të varura nga folja (la ciguë; qui a fait le coup)<sup>7</sup>. Edhe në kapitullin mbi foljen thuhet se kur është predikati i përbërë, folja është element primar, një e predikatit: Une hirondelle ne fait pas le printemps<sup>8</sup>, në të cilin predikat merret folja mohore *ne fait pas* me elementin pasues, pra me fjalën *-le printemps*, e që te ne konsiderohet një kundrinor.

Një vijë barazimi në mes predikatit të përbërë dhe sintagmës verbale, e ka theksuar edhe studiuesi frëng O. Soutet në tekstin e tij **La syntaxe du français** (botuar në Paris më 1989), kur thotë se *phrase comme lieu d' un predication: cette predication peut entre assuree evidemment par un syntagme verbal(SV) com en Le facteur distribue le courrier*<sup>9</sup>.

Nga këto pak të dhëna mund të nxjerrim përfundimi se kallëzues i thjeshtë foljor konsiderohet një folje e thjeshtë me kuptim të pavarur leksikor. Në këtë grup duhet të hyjnë edhe shprehjet foljore me kuptim pak a shumë të qëndrueshëm, pra të ashtuquajturat lokucione leksikore (me përbërës të qëndrueshëm dhe ato frazeologjike, siç janë idiomat, njësitë frazeologjike etj. , me kuptim figurativ, përgjithësisht) dhe lokucionet gramatikore ose siç quhen shpesh **shprehjet gjuhësore** në literaturën tonë. Kurse kallëzues i përbërë duhet të konsiderohet folja me gjymtyrët pasuese, si: kundrinori (i drejtë dhe i zhdrejtë), rrethanori, përcaktori kallëzuesor, madje edhe fjalitë e tëra të varura ftilluese e rrethanore. Pra, të gjitha elementet të cilat janë të varura nga folja me kuptim të plotë leksikor.

Pra, edhe teoria gjuhësore mbi kallëzuesin në gjuhësinë shqiptare, por edhe mbi gjymtyrët e tjera, është e udhës që edhe një herë të rishikohet nga studiues tanë, me qëllim që të shpjegohet drejt e qartë duke u mbështetur nga kritere të përcaktuara mirë në aspektin shkencor, sepse vetëm kështu shkencën mund ta shpiem përpara në korrelacion me atë evropiane e botërore.

---

<sup>7</sup>Po aty, f. 83.

<sup>8</sup>Po aty, f. 241.

<sup>9</sup>Shih tekstin e tij, f. 8.